



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 22.01.2020
Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR DHËNIE AMNISTIE”

- ***Hyrje***

Komisioni parlamentar për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi në mbledhjen e datës 22.01.2020 në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin **“Për dhënie amnistie”**.

Për të prezantuar projektligjin, në komision ishin të pranishëm, Ministria e Drejtësisë Znj. Etilda Gjonaj së bashku me stafin e saj.

Relatore për shqyrtimin e projektligjit ishte Znj. Ermonela Valikaj Felaj.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji është hartuar në përputhje me pikat 1 dhe 2, shkronja “ë”, të nenit 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe bazohet në parashikimet e nenit 71 të Kodit Penal, ku parashikohet e drejta e organit kompetent, domethënë Kuvendit të Shqipërisë, që me aktin e amnistisë të përjashtojë nga ndjekja penale, nga vuajtja e dënimit, tërësisht apo pjesërisht, ose të bëjë zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Projektligji është hartuar duke mbajtur në konsideratë që qëllimi i dënimit të dhënë të jetë arritur, ndërkohë që përmbajtja e projektligjit bazohet në respektin për të drejtën njerëzore për t’u trajtuar me dinjitet, nevojën për riintegrim dhe rehabilitim social,

ndyshimet pozitive në jetën e të dënuarve, si dhe trajtimin e tyre sipas standardeve evropiane në sistemin penitenciar.

Në këtë kuadër, nisma konsiston në amnistinë e dënimit, një ndërhyrje kjo pas dhënies së një vendimi përfundimtar dënimi, duke pushuar ekzekutimin e tij.

Projektligji në fjalë, vendos në fokus të veçantë **gratë dhe të miturit**, për të cilët **zbatohen kritere të posaçme lehtësuese, të ndryshme nga burrat.**

Përcaktimi i kriterëve lehtësuese për përfitimin nga amnistia, për të miturit dhe gratë, bëhet jo vetëm nisur nga humanizmi dhe ofrimi i mbështetjes më të lartë për këtë kategori, por edhe për shkak të pozitës më vulnerabël që paraqet përgjithësisht kjo kategori e të dënuarve.

Ofrimi i një trajtimi të diferencuar në këtë drejtim, është parë në harmoni të plotë dhe duke pasur veçanërisht në konsideratë, nevojat që lidhen me;

-kushtet personale, familjare, sociale të të dënuarave femra, të miturve dhe subjekteve që në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë të mitur

-si dhe moshën, arsimimin apo nevoja të tjera të të miturit.

➤ Po kështu, një vëmendje dhe analizë e kujdesshme i është kushtuar rrethanave psiko-sociale dhe mjedisit shoqëror që kanë diktuar vullnetin e autorëve femra apo të mitur në kryerjen e veprave të ndryshme penale.

Referuar llojit të veprave penale për të cilat janë dënuar pjesa më e madhe e personave të dënuar, femra dhe të mitur, të cilat më së shumti konsistojnë në krimet e ashtuquajtura “të varfërisë”, veprat penale në fushën e “drejtësisë” apo ato “kundër jetës”, rezulton se shkaqet kryesore që kanë diktuar përfshirjet në krim, lidhen ngushtësisht me kushtet e vështira ekonomike, viktimizimin si rezultat i dhunës në familje e shoqëri apo viktimizimin si rezultat i trafikimit.

Për këtë arsye, gratë dhe të miturit meritojnë një mundësi më shumë dhe një riintegrim social të qëndrueshëm.

Është treguar kujdes për kategorinë e sipërpërmendur, duke u limituar vetëm në atë masë dhe për ato lloje veprash penale, për të cilat ka një shkallë të lartë rrezikshmërie dhe për të cilat edhe ashpërsia e dënimit të dhënë është më e madhe.

Për këtë janë vendosur kriteret ndaluese për përfitimin e amnistisë, të parashikuara në nenin 4 të këtij projektligjit.

- **Diskutime**

Gjatë prezantimit të projektligjit, Znj.Gjonaj u shpreh se ndryshe nga amnistitë e mëparshme, kjo amnisti nuk **ka patur qëllim parësor uljen e mbipopullimit në burgje, por qëllim humanitar.**

Me fjalë të tjera, kjo amnisti liron përpara kohës së vuajtjes tërësore të dënimit, një kategori të dënuarish, që vlerësohen që për shkak të dënimit të mbetur ose veprës së lehtë për të cilën janë dënuar, të jenë subjekt i saj.

Gjatë hartimit të projektligjit, është mbajtur në konsideratë funksionimi i sistemit të dënimeve, sistem që mbështetet në parimin se sanksionet penale si “*ultima ratio*”, duhet të udhëhiqen nga parimet kushtetuese dhe funksionet që i karakterizojnë ato, siç janë:

-funksioni edukativ (funksioni i parandalimit të përgjithshëm të veprave penale) dhe
-funksioni parandalues që lidhet me riedukimin e autorit të veprës penale.

Mandej Znj.Gjonaj vuri theksin tek kategoritë e personave që përfitojnë nga kjo amnistia e që janë:

- të gjithë ata të cilët deri në datën 30.09.2019 dhe pavarësisht nga koha e mbetur e dënimit, janë dënuar me vendim të formës së prerë, me 2 vjet burg për burrat dhe 3 vjet burg për gratë dhe të miturit, ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim.
- të dënuarit me burgim, të cilëve deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 2 vjet për meshkujt dhe 3 vjet për femrat
- personat e dënuar femra, të cilat në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baraz ose mbi moshën 50 vjeç.
- personat e dënuar meshkuj, të cilët në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baraz ose mbi moshën 60 vjeç.
- personat e dënuar me burgim, të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë qenë baraz ose nën moshën 18 vjeç.

Sipas analizës së shprehur nga ministrja e drejtësisë znj Gjonaj, nga kjo amnisti përfitojnë 164 të dënuar në total, ku 141 janë meshkuj, 22 gra dhe 1 i mitur.

Ndërsa në lidhje me kategoritë që nuk përfitojnë nga kjo amnisti, Ministrja u shpreh se nga kjo amnisti nuk përfitojnë ata që janë dënuar për krime kundër njerëzimit, krime kundër jetës të kryera me dashje, vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, krime seksuale, vepra penale kundër lirisë së personit, vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, vepra me qëllime terroriste, krime kundër autoritetit të shtetit, vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale.

Gjithashtu, nuk amnistohen edhe kategoria e të dënuarve meshkuj të cilët përveç veprave penale të sipërpërmendura kanë kryer veprat penale të zhvillimit të palejuar të lojërave të fatit, veprat penale që çënojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve, vepra penale kundër mjedisit, vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, vepra penale kundër falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë, vepra penale kundër falsifikimit të dokumenteve, vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, vepra penale kundër drejtësisë .

Po ashtu, nuk përfitojnë amnisti personat që i shmangen ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të dënimit deri në datën 30.09.2019 si dhe përsëritësit e veprës penale:

Në përfundim të fjalës së saj, zonja Gjonaj, vuri theksin tek riintegrimi social dhe rehabilitimi i personave përfitues nga amnistia, duke u shprehur se Ministria e Drejtësisë ndër të tjera, nuk do të ndalojë punën e saj këtu.

Ministria me institucionet e varësisë, por edhe në bashkëpunim me institucionet qëndrore të linjës, do të ndjekë personat e amnistuar pas lirimit, veçanërisht gratë dhe të miturit, me qëllim mbështetjen e tyre për një riintegrim të qëndrueshëm në jetën sociale dhe ekonomike të vendit.

Në funksion të këtij qëllimi, do të krijohen dosje personale me të dhëna dhe informacione mbi veprën penale të kryer nga personat e amnistuar, dosje të cilat do të shërbejnë për të hartuar plane individuale riintegrimi, duke u fokusuar tek përbërja familjare, statusi social, gjendja ekonomike, arsimi dhe formimi profesional dhe punësimi.

➔Në vijim, fjalën e mori kryetarja e komisionit Znj.Felaj, njëkohësisht dhe relatore e projektligjit, e cila ritheksoi edhe njëherë rëndësinë e kësaj nisme.

Zonja Felaj u shpreh se akti i amnistisë është një akt për të cilin vendos Kuvendi i Shqipërisë, është një e drejtë e parlamentit, nëpërmjet së cilës bëhet e mundur përjashtimi nga ndjekja penale,nga vuajtja e dënimit tërësisht ose pjesërisht, sikundër me aktin e amnistisë mundësohet përjashtimi edhe nga ‘vuajtja’ e dënimit, për dënime që nuk janë vetëm ato me burgim, por edhe dënime më të lehta sikundër dënimi me gjobë që është një dënim kryesor apo dënime të tjera alternative.

Gjithashtu, ajo theksoi se me aktin e amnistisë vendoset edhe që dikush të përjashtohet nga ndjekja penale.

Kjo amnisti, sikurse edhe amnisti të tjera të viteve të fundit, si psh ajo e vitit 2016, nuk e përmbajnë këtë pjesë, pra përjashtimin nga ndjekja penale si një mundësi amnistimi, ndërkohë që amnisti të mëparshme e parashikonin përjashtimin nga ndjekja penale të personave që kanë kryer vepra me rrezikshmëri të ulët shoqërore.

Relatorja u shpreh se Kodi Penal i cili përcakton nocionin e amnistisë si akt (shih nenin 71 të tij), parashikon edhe që amnistia mund të përfshijë vepra penale të kryera deri një ditë para shpalljes së saj.

Në ligjin që amnistohet nga Ministria e Drejtësisë ka një datë dhe amnistia e propozuar shtrihet për të gjitha ato dënime që kanë marrë formë të prerë brenda datës 30.09.2019, ndërkohë persa i takon amnistimit të pjesës që ngelet nga vuajtja e mëtejshme e dënimit, do të ndiqet si afat ai që lidhet me hyrjen në fuqi të ligjit.

Rasti I propozuar në projektligj, është psh ai I personave të dënuar meshkuj, të cilëve deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit ju ka ngelur për të vuajtur 2 vjet burgim dhe të personave të dënuar femra dhe të mitur, të cilëve deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit, u ngelen për të vuajtur deri në 3 vjet burg ose ai që lidhet me mbushjen e moshës 50 vjeç dhe 60 vjeç deri në ditën e hyrjes në fuqi të ligjit, përkatësisht nga të dënuarit femra dhe meshkuj.

Relatorja theksoi se amnistitë e fundit kanë patur një nen të rëndësishëm në përmbajtje të tyr, që është neni i cili parashikon kriteret ndaluese, që përbën edhe thembrën e Akilit të çdo amnistie, pasi personat që kane kryer vepra penale të rënda dhe kanë rrezikshmëri të lartë shoqërore, duhet ta vuajnë dënimin e dhënë tërësisht dhe jo të përfitojnë nga akte të tilla si amnistia.

Në mbyllje të fjalës së saj, znj Felaj vlerësoi përfshirjen në kategorinë ndaluese për përfitimin e amnistisë, të veprës penale të “Futjes ose mbajtjes së sendeve të ndaluara në IEVP”, vepër e shtuar rishtaz në Kodin Penal. (shih nenin 324/a të Kodit Penal)

Anëtarët e komisionit, votuan “pro” projektligjit në parim ndërkohë që më parë drejtuan një sërë pyetjesh dhe diskutimesh në çështje që lidhen me numrin e personave që përfitojnë nga kjo amnisti, nëse ka patur raste të personave që kanë përfituar amnisti në 2016 dhe nga ai moment e deri tani janë dënuar përsëri dhe nese përfitojnë sërish nga kjo amnisti, pse nuk ka pasur që prej 3 vitesh amnisti dhe shkaqet që cuan në marrjen e kësaj iniciative për këtë vit.

U diskutua gjithashtu mbi shtyrjen e afatit deri në 31.12.2019 dhe përfshirjen në amnisti dhe të personave që janë në ndjekje penale për kundërvajtje penale si dhe shtrirjen e amnistisë dhe për disa vepra të tjera penale që cmohen si vepra me rrezikshmëri të ulët shoqërore.

- ***Riformulime nen për nen***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pas diskutimeve dhe pyetjeve drejtuar ministres, si

dhe duke marrë në konsideratë edhe çështjet e parashtruara nga relatorja dhe anëtarët e komisionit, i **sugjeron komisionit përgjegjës sa më poshtë vijon:**

Në nenin 1 të projektligjit, pika 1, sugjerohet që në qëllim të përfshihet edhe **“përfshijmë nga ndjekja penale e personave që kanë kryer kundravajtje penale”**

Komisioni përgjegjës të vendosë për afatin kohor që do të mbahet parasysh në këtë rast nëse propozimi mbështetet.

Në nenin 2 të projektligjit, në vijim të sa më lart, sugjerohet të shtohen si përkufizime, **ai i personave që janë në ndjekje penale dhe atyre që i janë shmangur ndjekjes penale ose hetimit dhe gjykimit.**

Në nenin 3 të projektligjit:

- **Në pikën 1 dhe 2** pas diskutimeve të shumta, anëtarët e komisionit edhe pse jo unanimisht (kundra këtij propozimi ishin kryetarja e komisionit, sekretarja e komisionit dhe një anëtar) sugjerojnë që afati për përfitimin e amnistisë të shtrihet për dënime të dhëna deri në datën 31.12.2019, duke u reflektuar i njëjti propozim edhe në nenin 2, pika 1 e projektligjit.
- **Pika 8** sugjerohet të hiqet nga përmbajtja e projektligjit me qëllim që asnjë i dënuar, pavarësisht qënies i mitur apo grua, që ka kryer një nga veprat penale për të cilat ndalohet dhënia e amnistisë, të mos përfitojë nga kjo amnisti.

Ligji penal, në rastin e dënimit të të miturve paraqitet absolutisht më i lehtë pasi që ata marrin vetëm gjysmën e dënimit të parashikuar për veprën, ndërkohë që edhe në dënimin penal të grave ndiqen politika më të lehtësuara dënimi.

Katalogu i veprave penale për kryerjen e të cilave nuk përfitohet nga amnistia nuk duhet të krijojë asnjë shteg nga ku të përfitohet. Në momentin që propozohet ky katalog duhet të jetë taksativ, përndryshe çënohet dhe kuptimi i tij dhe nevoja për ta pasur një barrierë të tillë ligjore.

Relatorja solli në vëmendje raste të fundit që kanë tronditur opinionin tonë publik e ku protagonist, autorë të veprave penale me pasojë të rënda, kanë qenë pikërisht të mitur.

Në nenin 4 të projektligjit:

- **Në pikën 1 e tij,** sugjerohet që në **gërmën “ë”** të shtohet edhe vepra penale e parashikuar nga neni 134 paragrafi i parë si një vepër shumë e përhapur dhe me një rrezikshmëri jo të vogël shoqërore krahasuar dhe me vepra të tjera për të cilat ndalohet dhënia e amnistisë.

Nga të dhënat statistikore të kriminalitetit për vitin 2019, të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Komisionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare, me

shkresën nr.394 prot, datë rezulton se numri i rasteve të referuara në organin e ndjekjes penale, vetëm për veprën penale të vjedhjes së thjeshtë të parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, është 4290.

Sa më lart tregon qartë që vepra penale e vjedhjes është rritur, sofistikuar po ashtu dhe nuk do të ishte vendimi i duhur, lejimi i amnistimit të vjedhjes së thjeshtë të parashikuar nga neni 134/1 I Kodit Penal.

- **Në piken 1, në gërmën “h”**, sugjerohet të hiqet nga kriteri ndalues për përfitimin e amnistisë, paragrafi i parë i nenit 199/a “Ndërtimi i paligjshëm” i Kodit Penal.

- ***Përfundim***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë dhe vendosi t’ia kalojë raportin me sugjerimet si më lart, komisionit përgjegjës, duke vlerësuar se:

- ***Në aspektin ligjor***, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- ***Në aspektin procedural***, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit,

Relatore /Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ